

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*

25.02.2025

Ora 11:53

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 3, depozituar nga qendra “Qëndresa Qytetare” me objekt “Shfuqizimi i vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin në Kryeministri. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. Ilirjan Rusmali, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj, znj. B. Ereqi
- **Parti Politike:** S’ka
- **Të tjerë:** Përfaqësues të Kryeministrit, Qendra “Qëndresa Qytetare”

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes, të kërkesës ankimore nr. 3, të depozituar në KQZ me datë 21 shkurt 2025, me ankues qendra “Qëndresa Qytetare” përfaqësuar me autorizim nga z. Dhimitër Zguro. Objekt i kësaj kërkesë ankimore është “Shfuqizimi i vendimit nr. 129, i datës 20.02.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin në Kryeministri. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit”. I pranishëm është përfaqësuesi i qendrës “Qëndresa Qytetare”. Ditën e djeshme administratës së KQZ-së i thashë për të njoftuar përveç Kryeministrit edhe Bashkinë Tiranë, meqenëse del nga raportimet që ka bërë Kryeministria në lidhje me aktivitetin. Është e pranishme përfaqësuesja e KQZ-së, ka të pranishëm nga Kryeministria. Ina si fillim në lidhje me njoftimet dhe pastaj për legjitimimin.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*

Znj. I. Osmanaj: Atëherë në lidhje me këtë seancë publike janë njoftuar përfaqësuesit: personi përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike në Kryeministri dhe personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Tiranë. Me Bashkinë Tiranë sapo pata një komunikim para fillimit të seancës publike dhe nuk do të paraqiten për arsye të tyre personale në këtë seancë.

Z. L. Braho: Dakord. Atëherë nga Kryeministria, kush është i pranishëm ju lutem për efekt procesverbali.


Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Adnor Shameti, këshilltar ligjor i Kryeministrit.

Znj. M. Koja, përfaqësues i Kryeministrit: Madalena Koja, juriste pranë Departamentit të Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, me autorizim.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Seanca e sotme ka të bëjë vetëm me elementët e formës dhe përmbajtjes, pra afati i kërkesës ankimore, kompetenca e KAS-it për të shqyrtuar kërkesën ankimore dhe forma. Kështu që shkurtimisht fjala në fillim për përfaqësuesen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në qoftë se kërkesa i plotëson këto elemente.

Znj. I. Osmanaj: Atëherë në datën 21.02.2025 kemi administruar ankimin, me ankues “Qëndresa Qytetare”, me objekt “Shfuqizimin e vendimit 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, për shqyrtimin e kërkesës së datës 20.02.2025 të organizatës qendra “Qëndresa Qytetare”, e cila pasi u shqyrtua

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*


nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim vendosi mospranimin e kërkesës “Qëndresa Qytetare” dhe mospranimin e kërkesës së organizatës, qendra “Qëndresa Qytetare”, për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Nga neni 130, i Kodit Zgjedhor konstatojmë se kërkesa është në kompetencë të KQZ-së, ankuesi ka legjitimitet dhe është respektuar afati, për këtë vlerësojmë që duhet të kalohet në seancë shqyrtimi nga KAS-i.

Z. L. Braho: Faleminderit! Fjala për përfaqësuesin e ankuesit të “Qëndresa Qytetare”, z. Zguro, në lidhje me elementët!

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Në lidhje me elementët, për sa i takon, sikundërse u relatua në datën 20, qendra “Qëndresa Qytetare” nëpërmjet emailit dhe komunikimit elektronik me KQZ-në i ka kërkuar ndalimin e një aktiviteti Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në kushtet kur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk e ka ndaluar veprimtarinë, veprimtaria ka ndodhur. Qendra “Qëndresa Qytetare” brenda datës 21, brenda një dite, në përputhje me afatin tre ditor të ankimit të vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka ankimuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si një vendim të padrejtë, duke i qëndruar të gjitha pretendimeve dhe në këndvështrimin tonë plotësojnë të gjitha elementët e formës, e përmbajtjes të ankimit dhe qendra “Qëndresa Qytetare” legjitimohet në këtë ankim, kështu që kërkojmë pranimin paraprak dhe kalimin e saj në seancë.

Z. L. Braho: Faleminderit! Fjala për përfaqësuesit e Kryeministrit në lidhje me këto elementë.

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*

Z. A. Shameti, përfaqësues i Kryeministrit: Faleminderit! Në radhë të parë ne kemi rezervat tona në lidhje me legjitimin aktiv dhe pasiv të ankimuesit në KAS, gjithsesi në çdo rast e lëmë në çmimin tuaj për këtë. Sa i takon thelbit të kërkesës dua të sqaroj që në radhë të parë dispozita ligjore e parashikon qartë ndalimin e një aktiviteti përpara zhvillimit të tij, jo pas zhvillimit të tij, që është ngritur në ankesë. Së dyti KQZ-ja ka pasur mundësi të ndalojë aktivitetin pasi është vënë në dijeni më përpara dhe janë ezauruar të gjitha detyrimet ligjore nga ana jonë, por nuk e ka bërë një gjë të tillë, ndaj nuk mund të veprojmë me efekt prapaveprues për ta cilësuar atë si të ndaluar pas zhvillimit. E treta, nuk ka prova konkrete për keqpërdorim të burimeve shtetërore ndaj pretendimet për ndalimin e aktivitetit është i pabazuar në ligj. Ndryshimi i vendndodhjes nuk përbën shkelje ligjore, pasi aktiviteti është raportuar brenda afateve dhe ka qenë transparent, Kryeministria dhe pse në cilësinë e institucionit të ftuar, ka njoftuar KQZ-në për ndryshimin e vendit dhe ka marrë miratimin e saj dhe së fundmi nuk ka asnjë dispozitë ligjore në Kodin Zgjedhor apo vendimin e KQZ-së që e konsiderojnë një ndryshim të tillë si shkelje automatike apo arsye për ndalimin e aktivitetit. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Unë kam një pyetje në fakt për përfaqësuesin e “Qëndresës Qytetare”, në lidhje me objektin e kërkesës tuaj ankimore, pra kërkoni shfuqizimin e vendimit të Komisionerit, vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës. Tani rruga procedurale normale është që, sa i përket sanksioneve administrative është Komisioneri që propozon në KAS, ndërkohë që pa e kaluar këtë fazë procedurale ju kërkoni që të vendosim ne, sanksionin administrativ ndaj personit përgjegjës dhe ndaj Kryeministrit. Si e justifikoni këtë proceduralisht ju? Pra gjithmonë flasim në aspektin procedural, a legjitimohet

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*

KAS-i në këtë fazë? Pra mesa shoh, ka dhe vendimmarrje të Komisionerit, ai e ka pushuar hetimin administrativ. Si e shihni proceduralisht këtë moment?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Atëherë për sa i takon këtij momenti, në vlerësimin tonë për të përmbushur dhe kushti. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve praktikisht ka lejuar zhvillimin e një veprimtarie publike, e cila duhet të ishte raportuar, nuk është raportuar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, e ka gjetur, le të themi, të ligjshme veprimtarinë e Kryeministrit. Në të tilla kushte, duke qenë se tani jemi “post factum”, pra kemi të bëjmë me një veprimtari të ndaluar, ne nuk mund të kërkojmë më, para Komisionerit, para Komisionit ndalimin e ndalimin e veprimtarive sepse nuk do të bënte sens, nuk do të kishte më bazë objekt, në të tilla kushte duke qenë se kemi të bëjmë me një veprimtari “post factum”, që tashmë ka ndodhur dhe Komisioneri si garant i parë që nuk do ta lejonte këtë veprimtari, duke qenë se Komisioneri nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ne i kërkojmë KAS-it që duke u ndodhur “post factum” të marrë sanksionin administrativ. Roli i Komisionerit është vetëm propozues. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mund të vendosë edhe sanksione, qoftë dhe ndaj subjekteve, duke bërë hetimin e vet administrativ, qoftë ndaj subjekteve që nuk janë propozuar nga ana e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, mbaj mend këtu vendimet të Komisionit të ndalimeve dhe sanksioneve ku në rast të caktuar është shprehur që duhet të hetohet për shembull në raste kur KSHZ-ja nuk e ka hetuar rolin administrativ, të partive politike që kanë përfituar nga shpërdorimi i burimeve publike, për analogji, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka bërë këtë evidentim, kështu që mendoj që edhe ky aspekt përmbushet në rastin konkret.

Z. L. Braho: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*

Z. I. Rusmali: Për ta sqaruar ndoshta dhe për ne më mirë, objekti i kërkesës tuaj te Komisioneri, cili ka qenë? Çfarë keni kërkuar ju specifikisht?

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i “Qëndresës Qytetare”: Objekti ynë të Komisioneri ka qenë “Ndalimi i veprimtarisë publike”. Në momentin që Komisioneri vendos ndalimin e veprimtarisë publike kryen dhe monitorimin nëse veprimtaria kryhet apo jo, nëse kryhet veprimtaria sigurisht do të ketë sanksione sepse kemi të bëjmë me zhvillimin e një veprimtarie të ndaluar qoftë në referim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, qoftë në referim të vendimit nr. 9. Në këto kushte kur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk e ka përmbushur detyrimin e tij, pra për të marrë një vendim, për të ndaluar këtë veprimtari dhe veprimtaria ka ndodhur, një veprimtari publike e paraportuar, sigurisht që mendojmë që legjitimohet qendra “Qëndresa Qytetare” qoftë për të kërkuar shfuqizimin, qoftë edhe vendosjen e sanksioneve administrative ndaj personave përgjegjës.

Z. L. Braho: Dakord. Faleminderit! Kam një pyetje për administratën e KQZ-së. Tani unë shoh këtu që ka disa emaile, pra aktiviteti ka qenë i raportuar për në ora 16.30, pra kur është bërë ajo shtyrja në orar dhe vendimi i Komisionerit është në ora 16.00, ndërkohë që shoh që “Qëndresa Qytetare” ka dërguar disa emaile përpara, pra rreth orës 13.20, 13.33, ku i referohet të dhënave publike, të cilat janë të ndryshme nga raportimi që kishte bërë Kryeministria. Ndërkohë që Bashkia Tiranë s’kishte bërë asnjë raportim. Tani i kanë marrë parasysh Komisioneri këto emaillet dhe këto informacionet publike, në vendimmarrjen e tij, apo ka gjykuar vetëm në bazë të raportimit që ka bërë Kryeministria?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.02.2025*

Znj. I. Osmanaj: Jo, janë marrë në shqyrtim të gjitha korrespondencat elektronike që kanë pasur edhe me “Qëndresën” sikurse edhe me Kryeministrinë deri në momentin që është bërë shpallja e vendimit nr.129.

Z. L. Braho: Dakord. Mirë atëherë, KAS do të tërhiqet për vendim në lidhje me plotësimin e kushteve dhe duke marrë parasysh dhe objektin e kërkesës ankimore. Mblidhemi për 15 minuta.

Rifillon seanca

Ora 12:21

Z. L. Braho:Riçelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të kërkesës ankimore nr. 3, të datës 21.02.2025. KAS pasi u tërhoq për vendim vendosi: pranimin pjesërisht dhe kalimin pjesërisht për shqyrtim administrativ të kërkesës ankimore dhe kalimin për shqyrtim më konkretisht vetëm për pikën 1 të objektit të ankimit të kërkuar nga ankuesi që ka të bëjë me “Shfuqizimin e vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Për sa i përket pikave 2 dhe 3 që kanë të bëjnë me vendosjen e sanksionit administrativ, KAS nuk kompetencë për t’i shqyrtuar këto kërkesa, si organ që vendos në lidhje me sanksionet vetëm në varësi të propozimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Seanca për shqyrtimin administrativ do të caktohet në datë 27 shkurt 2025, ora 15:00. Seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr.8

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

